



Kom.Dh.Shk.II.nr.50/2022

GJYKATA KOMERCIALE – DHOMA E SHKALLËS SË DYTË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Krenar Berisha dhe Saranda Bogaj-Shermeti, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses “P...” shpk, me nr te regj. te biz., me seli ne Prishtine, te cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.L avokat ne Prishtinë, kundër të paditurës A... shpk, me nr te regj. Te biz. 70789396, me seli në Prishtinë, rr. Shkupi nr.25, te cilën sipas autorizimit e përfaqëson D.P avokat ne Prishtinë, duke vendosur përkitazi me konfliktin e kompetencës, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 13.09.2022 mori këtë:

A K T V E N D I M

Për gjykim në këtë çështje juridike është kompetente në pikëpamje lëndore Gjykata Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, të cilës i dërgohen shkresat e lëndës në veprim të mëtejme.

A r s y e t i m

Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e saj është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore, për të vendosur në ceshtjen juridike kontestimore, sipas padisë me numër III.Ek.nr.128/2017.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Pergjithshem – Divizioni Civil, ka ushtruar propozim për vendosjen e konfliktit të kompetencës pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, me të cilën e ka iniciuar konfliktin e kompetencës duke konsideruar se Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Ekonomike, është kompetent në pikëpamje lëndore për vendosje në këtë çështje juridike.

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë pas shqyrtimit të shkresave të lëndës vlerëson se kompetent në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike është Gjykata Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, për arsye se objekt kontesti janë mosmarrëveshjet kontraktuale për shkak te denoncimit te kontratës se qirasë nga e paditura si dhe pretendimet e palës paditëse për demin e pësuar si pasoje e shkëputjes se njëanshme te kontratës se qirasë nga pala e paditur.

Nga shkresat e lendes rezulton se këtu palët ndërgjyqëse raportin e tyre kontraktual te qirasë e kane rregulluar ne kontratën e qirasë se datës 18.11.2011, e cila është nënshkruar nga përfaqësuesit e te dy subjekte afariste. Pra nga shikimi ne shkresat e lendes rezulton se te dyja palët ndërgjyqëse janë persona juridik, te cilat kane formën e organizimit të shoqërisë me përgjegjësi te

kufizuar, andaj sipas nenit 13 te Ligjit për Gjykatën Komerciale ne mënyrë decisive përcaktohet se gjykatë kompetente për te gjykuar ne këto konteste është Gjykata Komerciale, e ku nën par.1.1, i kësaj dispozite ka përcaktuar se “Gjykata Komerciale është kompetente për te gjykuar dhe ka juridiksion ekskluzivisht ne kontestet ndërmjet shoqërive tregtar vendore dhe te huaja si dhe kontestet ndërmjet personave juridik publik dhe privat, ne lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre.”, derisa nën par. 1.7 ka përcaktuar kompetencën e kësaj gjykate ne kontestet ndërmjet shoqërive tregtare lidhur me te drejtat sendore.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale për vendosje ne këto konteste rezulton edhe nga neni 37 par.2 i Ligjit për Gjykatën Komerciale, i cili ka përcaktuar se “ Me hyrjen në fuqi te këtij ligji, për çështjet te cilat rregullohen me këtë ligj, dispozitat e këtij ligji do te kenë epërsi mbi Ligjin ne fuqi për Procedurën Kontestimore, Ligjin ne fuqi për Konfliktet Administrative dhe Ligjin për Gjykatat”

Mbi këtë bazë Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë konstaton se gjykate kompetente për te vendosur ne këto çështje ne shkalle te pare është Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së parë.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 25.1 të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE – DHOMA E SHKALLËS SË DYTË
Kom.Dh.Shk.II.nr.50/2022 dt.13.09.2022

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Faton Bajrami, d.v